

# L I G J

Nr.8692, datë 16.11.2000

## PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN E BONIT "PËR MBROJTJEN E LLOJEVE SHTEGTUESE TË KAFSHËVE TË EGRA" DHE MIRËKUPTIMET E KËSAJ KONVENTE

Në mbështetje të neneve 78, 81, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e  
Këshillit të Ministrave,

### K U V E N D I

#### I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

#### V E N D O S I:

##### Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën e Bonit të datës 23.6.1979 "Për  
mbrojtjen e llojeve shtegtuese të kafshëve të egra" dhe mirëkuptimet e kësaj Konvente.

##### Neni 2

Autorizohet Këshilli i Ministrave për aderimin e Republikës së Shqipërisë në  
mirëkuptimet e mëpastajme në bazë të kësaj Konvente.

##### Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I  
Skënder Gjinushi

Shpallur me dekretin nr.2816, date 5.12.2000 te Presidentit te Republikes se Shqiperise  
Rexhep Meidani